



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: sekretariat@nocalbania.org.al • <http://www.nocalbania.org.al>

NJOFTIM PËR POZICIONIN

“Drejtor Projekti”

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, themeluar në vitin 1958, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj. KOKSH është organizata e vetme që përfaqëson Lëvizjen Olimpike Shqiptare, parimet e së cilës janë të detyrueshme për tu zbatuar nga të gjithë anëtarët e saj.

Në kuadër të Projektit “**Ekipe Sportive 2022**”, projekt i financuar nga Buxheti i Shtetit, KOKSH, fton kandidatët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e punës “**Drejtor Projekti**”

Objektivi i përgjithshëm i Projektit është krijimi i një Programi Kombëtar që nxit 1) sportin masiv, 2) zbulimin e talenteve, 3) edukatën sportive dhe parimet olimpike. Projekti do të formojë Ekipe sportive jashtë shkollore në nivelin 9-vjeçar (nga klasa e 6 – 9); në nivelin shkollë e mesme (nga klasa 10 – 12); në universitete.

Misioni i projektit është që përpos zhvillimit praktik të gjithë Skemës, të arrijë të ri-sjellë kulturën sportive që promovon një jetë aktive, të shëndetshme dhe parimet Olimpike si pjesë e jetës së përditshme.

Detyrat e Drejtorit të Projektit

Drejtori i Projektit është përgjegjës për planifikimin dhe mbikqyrjen e të gjitha aktiviteteve të projektit nga fillimi deri në përfundim të tij. Drejtori i Projektit vepron në përputhje me Legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe Projekt Propozimin e miratuar nga MAS për të menaxhuar çdo aspekt të projektit, duke përfshirë atë teknik, financiar dhe administrativ. Për të realizuar objektivat dhe rezultatet e vendosura, Drejtori i Projektit koordinon të gjitha proceset dhe burimet njerëzore në dispozicion të projektit. Për të përmbushur objektivat e caktuara, Drejtori i Projektit duhet të kryejë detyrat si më poshtë:



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: sekretariat@nocalbania.org.al • <http://www.nocalbania.org.al>

- Planifikon, realizon dhe finalizon projektin sipas afateve kohore dhe buxhetit të përcaktuar.
- Përcakton politikën, procedurat dhe dokumentacionin për planifikimin, zhvillimin, menaxhimin, ekzekutimin dhe kontrollimin e aktiviteteve të projektit.
- Interpreton dhe realizon në plan pune objektivat e projektit duke mbikqyrur zbatimin e tij sipas buxhetit dhe standardeve të cilësisë.
- Harton dhe zbaton strategji efektive për menaxhimin e kostove sipas buxhetit të aprovuar.
- Mbikqyr procedurat e prokurimit në funksion dhe nevojave të projektit
- Përfaqëson projektin me pale të treta për çështjet e lidhura me projektin.
- Mbikqyr dhe ndjek në mënyrë të vazhdueshme stafin në varësi, duke mbajtur përgjegjësi për performancën e tyre.
- Identifikon risqet potenciale dhe ndërmer veprime për ti mitiguar.
- Sigurohet që projekti të zbatohet në kohë, në përputhje me objektivat e vendosura dhe brenda buxhetit në dispozicion.
- Analizon dhe interpreton në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e projektit dhe paraqet raporte periodike për punën e tij dhe ecurinë e projektit.

Kualifikimet dhe Eksperienca:

- Të ketë përfunduar Fakultetin Ekonomik, Administrim Sportiv, Shkenca Sociale, Juridik etj si dhe të ketë kryer nivelin e dytë të studimeve master.
- Preferohen kandidatë me diplome master në Menaxhim.
- Preferohen kandidatë me njohuri sportive apo me eksperiencë të mëparshme të menaxhimit të projekteve sportive.
- Të ketë të paktën 7 vjet eksperiencë pune dhe të paktën 5 vjet eksperiencë menaxheriale.
- Të ketë eksperiencë të mëparshme në menaxhim projektësh.
- Të ketë njohuri të mira të gjuhës Angleze.



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: secretariat@nocalbania.org.al • <http://www.nocalbania.org.al>

Aftësi dhe kompetenca kryesore

- Të ketë aftësi shumë të mira menaxheriale, organizative dhe komunikuese.
- Përqasje pro-aktive në punë.
- Të ketë njohuri të metodave të ndryshme të menaxhimit të projektit.
- Të zotrojnë në nivel shumë të mire "Paketën Office".
- Aftësi drejtuese shumë të mira.

Procedura e aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat e aplikimit si më poshtë:

- Curriculum vitae (CV) në formatin Europass;
- Letër Interesi;
- Fotokopje të diplomave universitare;
- Dokumente të tjera mbështetëse (çertifikata të fituara nga trajnime, pjesëmarrje në konferenca, botime, letra reference, etj).

Kandidatët e interesuar duhet t'i dërgojnë dokumentet e aplikimit deri më datë 12 Maj 2022, ora 16.00, në adresën secretary.general@nocalbania.org.al, me subjekt: **Aplikim për pozicionin Drejtor Projekti "Ekipet Sportive 2022"**

